

Roskoveci

Një qytet në zhvillim, një destinacion turistik për t'u eksploruar

Shkurt 2023

Mirësevini në Roskovec

Jemi në Roskovec, qytetin e vetëm në Shqipëri që origjinën e ka nga një pazar dikur me emër, Pazari i Roskovecit, ose ndryshe njohur si Pazari i Frashërit. Këtë e vëren qartë nëse ndodh që në qytet të hysh nga rruga që vjen nga Berati. Një statujë e Tregtarit të Roskovecit të mirëpret dhe të fton të kthehesh me mendje të paktën dy shekuj më parë, kur këtu mblidheshin tregtarë nga mbarë jugu i Shqipërisë e më tej për të tregtuar produktet e tyre.

Por a ka pasur treg më herët? Dhe a është e vërtetë që Roskoveci ka shërbyer si stacion për udhëtarët që në lashtësinë e rrugës Egnatia?

Një moment i rëndësishëm në historinë e qytetit tonë është ngritja e ndërtesës së parë kompleks tregtar-hotelerie në vitin 1932, i cili shënohet si gurthemeli për zhvillimin urban të tij. Ndërtesa të tjera pasuan dhe pak nga pak qyteti tërhoqi vëmendjen jo vetëm si një stacion për udhëtarët apo ku zhvillohej tregu por edhe si vend për banim dhe për zhvillim veprimtarie biznesi.

Zbulimi i burimeve të naftës në zonën e Marinzës i ndryshoi rrjedhën zhvillimit të Roskovecit si qytet. Nëse më parë pesha ekonomike qëndronte tek bujqësia dhe tregtia, me kalimin e viteve nxjerrja e naftës u kthye në burim punësimi për shumë naftëtarë që u vendosën nga zona të ndryshme të Shqipërisë, gjë që vlen edhe në ditët e sotme.

Por qyteti meriton të njihet për shumë më tepër se kaq. Trashëgimia natyrore me kodrat e buta dhe peizazhin e mrekullueshëm, Kënetën e Zezë, Liqenin e Kurjanit dhe Pyllin e Luarit, hipoteza historike lidhur me stacionin Stephanaphana të rrugës Egnatia, trashëgimia kulturore me Kishën e Shën Nikollës dhe Shën Gjergjit, misteri i Kënetës së Zezë, legjenda e Bukuroshes së Strumës, ushqimi i shijshëm dhe mikpritja e bujaria jonë janë arsye të mjaftueshme për t'ju ftuar për një përvojë

turistike. Dhe ndërsa përgatiteni për Roskovecin si destinacion i ri, shfletoni fillimisht këtë guidë për të mësuar pak më shumë për të.

GJEOGRAFIA E ROSKOVECIT

Bashkia e Roskovecit është pjesë integrale e territorit të Qarkut Fier, një nga 12 qarqet e vendit, që ndodhet në pjesën jugperëndimore të vendit në një terren kodrinor të ulët dhe fushor (pjesë e fushës së Myzeqesë).

Roskoveci ndodhet në pjesën juglindore të fushës së Myzeqesë, pikërisht në kufi me kodrat e Mallakastrës. Kufizimi me bashkinë Lushnjë në veri, me Mallakastrën në jug, me Urën Vajgurore në lindje, me bashkinë Patos në jugperëndim, e bën atë një qendër urëkalimi të një zone me sipërfaqe 118.01 km². Kryeqendra e saj është qyteti i Roskovecit.

Fusha e Roskovecit, e formuar nga depozitimet e Semanit 1.5-2 milion vjet më parë, nuk është krejt e rrafshët. Vargjet kodrinore me lartësi më të madhe (mbi 250 m) ndodhen në pjesën lindore, ato me lartësi mesatare (100-150 m) shtrihen në zonën qendrore dhe shkojnë deri në fushë, kurse zonat e ulëta ose fusha e “Myzeqesë” shtrihen në veriperëndim, perëndim dhe jugperëndim të territorit.

Hidrografia përbëhet nga lumi Seman, disa përrenj që e furnizojnë atë, liqeni artificial i Kurjanit dhe Këneta e Zezë e Strumit, një pjesë e rëndësishme ekologjike, pjesërisht e dëmtuar, por edhe e pashfrytëzuar. Kolektori i tokave të fushës së Myzeqesë dhe lumi Seman e kufizojnë bashkinë e Roskovecit nga rajonet e tjera.

Pozita gjeografike e Roskovecit është e favorshme lidhur me pozicionimin e saj në afërsi të rrugëve kombëtare Tiranë – Vlorë, Fier – Berat, por edhe me mundësinë e lidhjes me zona të tjera si Kurjanin, Beratin e Tepelenën nëpërmjet rrugës Roskovec – Kurjan.

Qyteti i Roskovecit ka një sipërfaqe prej rreth 1000 ha dhe zona urbane e saj përbën rreth 25.7% të kësaj sipërfaqeje.

Klima e Roskovecit është tipike mesdhetare, me verë të ngrohtë dhe të thatë dhe dimër të butë dhe të lagësht. Temperatura mesatare vjetore është 15 gradë Celsius. Muaji më i ftohtë, janari, karakterizohet nga një mesatare prej 7 gradë Celsius, ndërsa muaji më i ngrohtë, korriku, shënon një mesatare prej 23-24 gradë Celsius. Reshjet bien në formë shiu, kyesisht gjatë gjysmës së ftohtë të vitit dhe sasia mesatare e tyre arrin deri në 1000 mm. Rrezatimi diellor llogaritet në rreth 2000 orë me diell në vit, të cilat krijojnë kushtet e zhvillimit të një vegjetacioni të pasur dhe bujqësie të begatë.

Sipas ndarjes territoriale të vitit 2014 (Fletorja Zyrtare Viti 2014, Nr. 137, fq.6370), bashkia e Roskovecit përbëhet nga katër njësi administrative dhe administron qytetin dhe 14 fshatra:

- Roskovec (me fshatin Jagodinë)
- Kuman (me fshatrat Kuman, Marinëz, Vidhishtë, Luar)
- Kurjan (me fshatrat Kurjan, Mbërs, Ngjeqan, Vlosh)
- Strum (me fshatrat Strum, Arapaj, Suk 1, Suk 2, Velmish).



Territori i bashkisë së Roskovecit shtrihet pjesërisht mbi zonën naftëmbajtëse Patos-Marinzë e cila përbën një burim natyror të rëndësishëm dhe potencial për zhvillimin ekonomik.

Industria e rëndë nxjerrëse

Bashkia e Roskovecit është e pasur me rezerva hidrokarburesh, naftë dhe më pak gaz natyror. Ky resurs shfrytëzohet masivisht në Marinzë, Njësia Administrative Kuman dhe në Jagodinë, Njësia Administrative Roskovec.

Infrastruktura e ujitjes – Rezervuarët

Hidrografia në territorin e bashkisë Roskovec përbëhet nga:

- Këneta e Zezë

- Rezervuari i Kurjanit, i cili furnizohet nga përroi i Kurjanit dhe përroi i Cukalatit
- Rezervuari i Ngjeqarit, i cili furnizohet nga mbledhja e ujërave natyrore (shirave dhe burimeve ujore nëntokësore).

Të gjitha këto burime ujrore kanë vlerë të madhe, pasi nëpërmjet tyre realizohet vaditja e tokave, e cila bën të mundur realizimin e prodhueshmërisë bujqësore.

Lumenjtë

Semani është i rëndësishëm jo vetëm nga pikëpamja hidrike, por edhe nga impakti mjedisor që shkakton. Lumi Seman është burimi hidrik nga i cili marrin sasi të konsiderueshme për vaditjen e tokave banorët e zonës në fshatrat Jagodinë, Suk dhe Arapaj.

Ekonomia

Sektorët që ofrojnë punësim për banorët e zonës janë: industria e nxjerrjes së naftës, sektori i ndërtimit, bujqësia, blegtoria dhe pemëtaria, tregtia dhe pemëtaria.

HISTORIA E ROSKOVECIT QYTET

Toponimi i stacionit Stephanafana që arkeologu austriak Kamilo Prashniker sjell në lidhje me Roskovecin e ka burimin në kërkimet e tij për të gjetur degën jugore të rrugës Egnatia duke u nisur nga Apolonia. Shënimet e Prashniker në librin “Myzeqeja dhe Mallakastra” botuar në Vjenë në vitin 1920 japin këtë dëshmi:

...rruga i shmanget këtij moçali duke bërë një kthesë në formë harku drejt jugut deri në Novoselë. Aty i humb përsëri gjurmët e saj për të gjetur përsëri trasenë të ngritur vetëm pranë Kumanit, ngjitur me bregun e djathtë të përroit të Allambrezit. Prapëseprapë mbi vijën e ndjekur prej saj nuk ka asnjë dyshim. Ajo ka ndjekur rrugën e sotshme nëpër qafën e përdorur akoma edhe sot, shkon në vijë të drejtë deri te Hani i Roskovecit. Te hani arrijmë në bazë të numrit të miljeve stacionin (mutation) Stephanaphana.

Sikurse dëshmon historiani Ilirian Gjika i cili ka hulumtuar lidhur me Prashniker dhe ka studiuar me përkushtim zonën tonë, kjo hipotezë me interes e ngritur në vitin 1920 mbështetet edhe nga toponimi Qafa e Stefanit në afërsi të Kumanit. Rezultatet e Prashniker dhe toponimi që vijon të përdoret edhe në ditët e sotme janë për historianin Gjika një argument i fortë që Stephanaphana nuk është gjë tjetër përveçse Roskoveci i sotëm.

Kjo hipotezë dhe argumenti mbështetës për vërtetësinë e saj sjellin një dritë interesante mbi studimin e historisë së Roskovecit. Ato na japin një këndvështrim tjetër mbi arsyet se pse deri në ditët tona Roskoveci është konsideruar si qytet stacion. Sikurse shprehet historiani Gjika, udhëtari gjerman Gustav Vaigand, i cili në vitin 1889 kaloi për arsye studimore përgjatë rrugës nga Berati drejt Fierit shkruante këto shënime:

Hymë në fshatin Pobrat, i cili shtrihej pranë një fushe dhe afër drekës ishim në fshatin Roskovec, që i thonë edhe Frashër.

Kishte shumë bujtës, pasi këtu bënëin pushim udhëtarët që shkonin në Vlorë dhe Berat...

Përveçse si stacion qëndrimi në shekullin XIX ekzistojnë mjaft dëshmi që tregojnë që Roskoveci shquhej edhe si vend i pazarit me të njëtin emër. Sipas studiuesit Zija Shkodra, në Shqipërinë e Jugut pazaret më të njohur në shekullin XIX kanë qenë ai i Roskovecit në Myzeqe dhe i Këlcyrës në Përmet. Në Pazarin e Frashërit siç quhej ai dikur tregtoheshin prodhime bujqësore e blegtorale, prodhime artizanale dhe të fabrikuara brenda apo jashtë vendit. Veprimtaria e Pazarit për mbi një shekull përcaktoi një rol thelbësor në rritjen e rëndësisë për vendndodhjen Frashër/Roskovec, e cila në vijim, në shekullin XX u kthye fillimisht në qendër administrative komune dhe disa dekada më vonë në qytet.

Sikurse bënë të ditur historian Nuri Plaku, Roskoveci në vitin 1922 rezulton se kishte 25 shtëpi me 170 banorë. Në vitin 1923 ai u bë për herë të parë qendër administrative me statusin e krahinarisë dhe vula e administratës mbante emërtimin “Pazari i Frashërit”. Si qendër administrative Pazari i Frashërit administronte 32 fshatra dhe ishte në përbërje të Prefekturës së Beratit.

Pas vitit 1922 nisi ngritja e rrjetit të shërbimeve për banorët me dyqane tregtare e punishte zejtarie që përfshinte kovaçanën e parë, teneqepunuesin, furrat e para të pjekjes së bukës, samarpunuesit, këpucarët, zdrukthtarët, etj. Karakteristikë e këtyre dyqaneve dhe punishteve ishte që ishin të tipit baraka prej dërrase apo prej muri të punuara me shtylla, balte dhe kallama.

Historia e urbanizimit të Roskovecit është e lidhur me emrin e Ali Ibrahim Çepeles bashkë me të disa tregtarëve e drejtuesve të disa punishteve që funksiononin në Pazarin e Roskovecit njohur ndryshe si Pazari i Frashërit. Sipas hulumtimeve të historianit Nuri Plaku, pas zgjerimit të numrit të punishteve dhe njësisve tregtare në harkun e

dhjetë viteve 1922-1932, ishte pikërisht Ali Ibrahim Çepele ai i cili në vitin 1932 ndërtoi mu në qendër të Roskovecit një hotel dykatësh me arkitekturë moderne të nivelit bashkëkohor me një sistem të gjerë shërbimesh. Kjo ndërtesë, e cila në katin e parë kishte një farmaci, kazino, rrojtore, furrë buke dhe dy magazina dhe në katin e dytë shërbente si hoteleri me 15 dhoma, do të kthehej shpejt në pikën e gravitetit dhe të zhvillimit urban të kësaj qendre. Në vitin 1936 ai ndërtoi shtëpi dhe erdhi me banim në Roskovec. Pas tij erdhën u vendosën me shtëpi edhe familje të tjera si ajo e Anastas Hebesë, familjet Zavalani, Poda, Selenica, Frashëri, etj.

Në vitin 1956 Roskoveci u kthye në lokalitet i rrethit të Fierit duke u ndarë nga Berati, ndërsa në vitin 1969 mori zyrtarisht titullin qytet. Jeta ekonomike e qytetit ishte ngushtësisht e lidhur me zhvillimin e agrar në dalje të tij me fokus në rritjen e dërrit, shpendëve, mbarështimin e lopëve, vitikulturën, frutikulturën, si dhe kultivimin e duhanit me emërtimin "Roskoveci". Por qyteti nuk arriti dot një transformim urban siç do të ishte pritur.

Në fakt deri më sot ka pasur vetëm dy projekte themelore të mbështetur nga qeveria për urbanizimin e Roskovecit. Projekti i parë ka qenë i vitit 1927 dhe synonte ta shndërronte Roskovecin në qytet bashkëkohor, por nuk u realizua për arsye financiare. Në kuadër të përpjekjeve për realizimin e këtij projekti nisën ndërtimet e para të shërbimeve në anët e rrugës që u përmendën më lart. Projekti i dytë ishte ai i vitit 2018 për zhvillimin e qendrës së qytetit dhe mban firmën e kryetares aktuale të bashkisë, znj.Majlinda Bufi. Me mbështetjen financiare që akordoi qeveria, u spostua rruga automobilistike në lindje, në unazën e madhe dhe qendra u pasurua me një shesh të rëndësishëm.

TRASHËGIMIA NATYRORE DHE FESTAT E LIDHURA ME TË

Këneta e Zezë

Pavarësisht përpjekjeve në kohën e diktaturës, Këneta e Zezë nuk u arrit të thahej. Burimet e saj të pashtershme e mbajnë ende të tillë sot, bashkë me një ekosistem unik me florë dhe faunë të pasur që meriton të hulumtohet nga biologët.

Prej se kur u hoq dorë prej idesë për ta tharë, uji i kënetës nisi të shfrytëzohej për mbushjen e Liqenit të Kurjanit. Ai dërgohej me pompa në këtë liqen-rezervuar e prej aty në tokat bujqësore për vaditje.

Në ditët e sotme, bashkia e Roskovecit synon që ta shndërrojë kënetën në një destinacion argëtues dhe turistik.

Kodra e Kurjanit

Nga kodra më e lartë e Kurjanit ku ndodhet edhe kisha e Shën Nikollës, syri të kap gjithë rrafshinën e Myzeqesë, Shpiragun dhe kodrat e Mallakastrës. Është një vendndodhje ku ia vlen të shpenzosh kohë për të njohur krejt zonën, për të shijuar ngjyrat e natyrës dhe diellin si dhe për të bërë foto të paharrueshme. Jo më kot është pikërisht ky vendi që është zgjedhur nga Bashkia për të zhvilluar festën e Ullirit, e cila është një traditë e bukur që mbledh çdo vit me qindra adhurues të ullirit dhe natyrës në përgjithësi.

Liqeni i Kurjanit dhe festa e 1 Majit

Liqeni i Kurjanit aktualisht është vendi që mbledh roskoveçarët në piknikun e festës së 1 Majit. Ndërkohë në pjesën tjetër të vitit ai është

një vendndodhje natyrore pak e vizituar. Kjo hapësirë e madhe dhe e hijshme ujore bashkë me kodrat e buta që e rrethojnë ka potencial për t'u zhvilluar nga ana turistike.

Fshati Luar dhe Pylli i Luarit

Fshati Luar, me reliev kodrinor dhe natyrë piktoreske, është përfshirë në projektin “100 fshatrat turistike shqiptare” me ç'rast ai ka hyrë në një hartë interesante të promovimit të destinacioneve shqiptare të agroturizmit. Ulliri është pema që e karakterizon peizazhin e këtij fshati por më tej edhe të krejt bashkisë së Roskovecit.

Në daljet të tij ndodhet Pylli i Luarit, i mbushur me pisha të buta dhe me sipërfaqe prej 3 hektarësh. Ky pyll është vend i përshtatshëm për qëndrim dhe ecje në natyrë.

Ullishtat dhe Festa e Ullirit

Ulliri i kultivuar në këtë zonë të Shqipërisë qysh në lashtësi, sikurse e dëshmojnë gjetjet e amforave të vajit në vendbanimet fqinje të Apolonisë, Margëlliçit (Patosit), Antipatreas (Beratit), Dimalit, apo Bylisit, është sot pjesë deri edhe e emblemës së bashkisë së Roskovecit.

Sipas statistikave këtu kultivohen rreth 450 000 rrënjë ullinj, të cilët përveç zonës kodrinore që e ka traditë brez pas brezi, mbillen me shumicë edhe në zonën e ulët fushore. Kjo kulturë përdoret gjerësisht në fushën e kulinarisë si ulli kokër për tavolinë, si dhe për të prodhuar vaj, që shfrytëzohet për gatime të ndryshme dhe përgatitjen e sallatave.

Pikërisht ky vaj është edhe baza për festën e Ullirit e cila që prej vitit 2016 zhvillohet në kodrën e Kurjanit, në oborrin e kishës së Shën Nikollës. Festa shërben për promovimin e vajit të ri të prodhuar nga fabrikat vendase. Përveç aktiviteteve shoqëruese si koncerte dhe panair me produkte bujqësore dhe blegtorale, në të zakonisht ndahet një çmim për vajin më cilësor të vitit. Kjo festë konsiderohet si vlerë e shtuar që shkon në dobi të qytetarëve të Roskovecit.

TRASHËGIMIA KULTURORE

Dëshmitë materiale dhe jo-materiale të trashëgimisë kulturore janë një arsye e fortë për të pasur kureshtje për të paktën një vizitë në bashkinë tonë.

Kisha e Shën Nikollës

Ngritur mbi kodrën më të lartë të zonës që duket si një pikë strategjike për të pasur një vështrim 360-gradësh mbi Myzeqenë, kisha e Shën Nikollës në fshatin Kurjan përbën vendndodhjen më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të Roskovecit.

Andrea Llukani shprehet se kisha mendohet se është ndërtuar në shekullin XIV në stil bizantin. Ajo përbëhet nga naosi dhe nartekxi. Ndërtimi është bërë me muraturë me tulla të kuqe dhe gurë të skuadruar tek qoshet. Kupola është shembur dhe sot është zëvendësuar nga një çati prej druri dhe tjegullash. Kishës i mungon portiku që ndodhej në anën perëndimore të saj, si dhe dy portikë të vegjël që mbulonin portat veriore dhe jugore të naosit. Kanë mbetur vetëm bazamentet dhe disa kapitele antike të stilit dorik. Nuk është e qartë nëse ato janë mbetjet e një tempulli pagan apo janë transportuar nga diku tjetër, për shembull nga Apolonia. Llukani vijon:

Në vitin 1956 gjatë punës kërkimore të një ekspedite të Universitetit të Tiranës u zbulua se afresket e kishës së Kurjanit janë pikturuar në vitin 1578. Nga një mbishkrim që gjendet mbi suva në nikën e prothesit në kungë mësojmë se afresket e kishës janë pikturuar nga Nikolla Onufri dhe ndihmësi i tij Joani: "Kur të ngresh duart para Perëndisë o meshtar i Perëndisë, më përmend dhe mua mëkatarin, dhe të paditurin Janin dhe Nikollën. Lutuni për zotëritë. Amin"

Gjatë pikturimit të afreskeve të kishës ikonografët janë ndikuar nga piktura e Pojanit. Në këtë kishë gjendet skena e "Kungimit të Marisë egjiptiane nga jerondi Zosima". Këtë skenë e hasim më parë në Pojan. Afresket e kishës së Kurjanit janë të stilit bizantin. Tek to shihen gjithashtu tendenca të traditës vendase. Fragmentet e afreskave të kishës së "Shën Nikollës" në Kurjan kanë ngjashmëri me ata të trapezarisë së manastirit të Pojanit. Tek të dy këto kisha hasim motivin e imitacionit të pllakave prej mermeri në formë këndëdrejtë. Në prill të vitit 1782 kisha është restauruar. Këtë fakt e vërteton një mbishkrim i gdhendur në gur në portën perëndimore të kishës: "Viti 1782. Prill"

Kisha e Shën Gjergjit

Në Strumë të Roskovecit, në mes të gjelbërimit ngrihet kisha e Shën Gjergjit, një objekt kulti me arkitekturë të bukur, por aktualisht në gjendje jo të mirë dhe me nevojë të menjëhershme për restuarim.

Andrea Llukani në librin "Ndiheja e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkimeve dhe objekteve liturgjike fetare" (fq.162) paraqet sa vijon lidhur me kishën e Shën Gjergjit:

Kisha e Shën Gjergjit përbëhet nga naosi dhe hajetet. Naosi është njënefësh me përmasa të brendshme 14.0x5.50 metra. Kisha mbulohet nga një tavan druri. Altari i kishës ndahet nga naosi me anën e një ikonostasi prej druri të gdhendur. Kambaneria gjendet në anën perëndimore të kishës, mbi porten hyrëse. Muratura e kishës është prej guri. Apsida ka muraturë të thjeshtë dhe përfundon me një kornizë.

Kisha e Shën Gjergjit është pikturuar prej Joan Cetirit dhe nipit të tij Nikollës, në vitin 1801. Mbi portën perëndimore brenda kishës gjendet mbishkrimi: "U pikturua ky tempull në vitin shpëtimtar 1801 dhe u përfundua në muajin tetor 5, me dorën e

Joan Çetirit dhe Nikollës, nipit të tij, nga qyteti Grabovë, në kohën të gjithirshmit Mitropolitit të Beratit, zotit Joasaf dhe prift Llazarit ekonomit dhe në vazhdim të tjetër, të cilët i kujtoftë zoti ynë, Jesu Krisht në mbretërinë e qiejve.

Gurma e restaurimi të fundit është e vitit 1935 dhe është shënuar në hyrjen e kishës:

NDREQJE KAMBANAVE
NE KUJDESTARIN JAN ÇOBO
DHE LIN STAMBOLLIUT
ME 25 GUSHT VITI 1935
E BERE PREJ USTA VASIL LAPI

Trashëgimia jo-materiale

Toponimi i sotëm Qafa e Stefanit dhe Stephanaphana e rrugës Egnatia

Edhe sot në hyrje të Roskovecit ruhet emri i një qafe të vogël në të cilën kalon rruga që vjen nga Fieri. Është pikërisht kjo qafë që mban emrin Qafa e Stefanit që, sipas historianit Ilirjan Gjika, ndihmon për të bërë një lidhje midis stacionit Stephanaphana në degën jugore të rrugës Egnatia duke u nisur nga Apollonia dhe Roskovecit të sotëm.

Sipas arkeologut austriak Prashniker, numri i miljeve të numëruara nga Apollonia deri në Hanin e Roskovecit është i njëjtë me atë që parashikohet në itinerarin Hisrosomilitan (i Burdigalës) – itinerari më i vjetër i krishterë që nisej nga Bordoja (Burdigala dikur) dhe përfundonte në Jeruzalem. Kjo lidhje e Roskovecit me Stephanaphanën jep hapësirë për hulumtime të mëtejshme në burime historike që mund të japin të dhëna për këtë vendndodhje në periudha të ndryshme të historisë, të cilat urojmë që të ndodhin në të ardhmen.



Itinerari Burdigalens

Toponimi Kurjan

Sikurse vë në dukje Andrea Llukani në librin "Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike fetare" (fq.55-56), Prof.Pëllumb Xhufi ngre një tezë interesante për fshatin Kurjan ku ndodhet kisha e Shën Nikollës. Kjo hipotezë e Xhufit e paraqitur në librin "Nga paleologët tek Muzakajt" (fq.215) na ndihmon që ta lidhim ndërtimin ose restaurimin e kësaj kishe me kyr Janin (përkthyer në shqip: zoti Joan), i cili mund të ketë qenë një nga nëpunësit e lartë të perandorisë bizantine. Pra fshati vetë mund të ketë marrë emrin nga kyr Jani, ndërtuesi ose meremetuesi i kishës së Shën Nikollës.

Pazari i Frashërit apo i Roskovecit

Sipas studiuesit Ilirjan Gjika, Pazari i Roskovecit është fjalë simbolike, e cila është futur edhe në fjalorin etnologjik. Kemi të bëjmë me një panair popullor, ku blinin, takoheshin dhe bëheshin lidhje bashkëshortore.

Dita e Pazarit ishte dita e enjte, për arsye se të dielën u ishte dhënë mundësia popullsisë së krishterë për të marrë shërbesën fetare. Kjo përbën një dëshmi më shumë për përbërjen fetare të popullsisë së zonës së Roskovecit deri vonë në shekullin XIX.

Studiuesit Gjovalin Shkurtaç, Tefë Topalli dhe Artjon Shkurtaç ndërkohë bëjnë të ditur në librin e tyre “Sociolinguistikë e shqipes: Nga dialektologjia te etnografia e të folurit” se Pazari i Roskovecit ka shërbyer si pikë ku është zhvilluar “tregu i gjuhës” për trevat fushore të Myzeqesë e më gjerë. Parë në këtë këndvështrim, qytetit tonë i takon një meritë për unifikimin e dialekteve të jugut që mbase ndryshe nuk do të kishte ndodhur në të njëjtën mënyrë.

Kënga popullore e Bukuroshes së Strumës

Në fund të viteve '70, ish-diktatori Hoxha, i cili në rini të hershme kishte vizituar dhe kishte qëndruar në Roskovec, shfaqti interes për një këngë popullore që roskovecarët i kishin kushtuar Bukuroshes së Strumës. I kujtoheshin vetëm disa vargje dhe insistimi i tij për ta ringritur këngën bëri që shumë njerëz u angazhuan për të gjetur tekstin e plotë. Ky tekst nuk u gjet dhe kënga u riprodhua me të njëjtin titull por me tjetër tekst dhe u paraqit në festivalin e Gjirokastrës në vitin 1983 e kënguar nga grupi i Fierit si vijon:

Moj thëllëzë e malit
Me llërë përveshur
Dil të shoh një herë me sy

Aman, aman, me buzë duke qeshur.
Gocë, ç'u hodhe në va
Vajte tek burimi
Fol një herë me gojë,
Moj Bukuroshe Strumit
Me shtëmbë në krahë.
Gocë, në anën e brezit
Mbaje një kërma,
Fol një herë me gojë,
moj bukuroshe Strumit.
Me shtëmbë në krahë,
Gocë, ngrije pak shaminë,
Mos të shoh bukurinë
Fol një herë me gojë,
moj Bukuroshe Strumit.

Por historiani Nuri Plaku, pasi ishte njohur me Pandeli Priftin nga Strumi, i cili ishte larguar shumë herët nga fshati, paraqet një tekst për këngën që sipas Priftit është varianti origjinal i saj. Teksti vijon si më poshtë:

Thëllëzë kur zbret nga mali
Me llërë përveshur
Me buzë duke qeshur.
Thëllëzë, më shkoje në lum
Më hidheshe në va
Me shtëmbë në krah.
Ah, moj bukuroshja e Strumit, ah!
Me dy qetë e zezë,
Lëroje në arë
Me kindat e fustanit lesoje ugar
Ah moj Shën Mëri e Strumit, ah!
Në anë të brezit më mbaje një kërma
Ah, moj Bukuroshja e Strumit, ah!

Seç të erdhi beu, të vrau nënën dhe babanë
Ah, moj Shën Mëri e Strumit, ah!
Seç nxorre kërmanë, qëlllove beun dhe qehajanë.
Ah, moj Shën Mëri e Strumit, ah!

Legjendat

Misteri i Kënetës së Zezë

Askush nuk di ta përshkruajë saktë se çfarë ka dëgjuar për netë të tëra rreth 20 vjet më parë në Strum të Roskovecit. Banorët i mbajnë mend ende ulërimat e forta që mbajtën gjallë kureshtjen por edhe tmerrin e tyre. Hipotezat për këtë mister janë të larmishme dhe burimi i pashtershëm i ujit dhe e zeza e tij vetëm se e shtojnë kureshtjen por edhe misterin e lidhur me këtë kujtesë të qytetit dhe fshatrave përreth tij.

Ka prej banorëve që thonë se ishin ulërima njeriu. Ka të tjerë që pohojnë që ishin ulërima kafshe pylli por ka edhe nga ata që mendojnë se mund të ketë qenë balenë e ardhur nga ujërat e detit. Një variant tjetër mendimi është se këto janë dukuri të zakonshme të lidhura me shfryrjen e natyrshme që bën toka e kënetës sidomos në muajin shkurt që është sezoni i natyrshëm i “ulërimave” të saj.

Bukuroshja e Strumit

A ka ekzistuar vërtet Bukuroshja e Strumit? Siç ndodh me legjendat ato nuk dihet se ku fillojnë e ku mbarojnë në raport me realitetin.

Ndonëse ka edhe nga ata që thonë se nuk ka pasur kurrë një Bukuroshe Strumi si ajo e legjendës, thuhet se ngjarja që frymëzoi lindjen e një kënge të popullit ka ndodhur në gjysmën e dytë të shekullit të XIX në Strum, në lagjen afër kishës së Shën Gjergjit.

Një çift kishte lindur shumë fëmijë, por prej tyre vetëm një vajzë kishte arritur të rritej në moshën në të cilën hiret e saj kishin pushtuar zemrat e gjithë djemve të fshatit. Madje, nga bukuria e saj thuhet se u marros edhe vetë prifti. Si të gjitha vajzat myzeqare, ajo merrej me punët e shtëpisë dhe shpesh ndihmonte edhe të atin në punët e bujqësisë. Bukuria e vajzës ngjalli konflikte midis djemve, aq sa të prishte qetësinë e fshatit. Prifti bashkë me kryepleqësinë e fshatit organizoi një besëlidhje të llojit të rrallë në historinë tonë. Ajo nuk u lidh as për gjak e as për nder, por për të mos përlyer bukurinë. Sipas kësaj besëlidhjeje djemtë nuk do të merrnin nuse nga fshati. Të gjithë do të shihnin njëri-tjetrin si motra e vëllezër të një gjaku. Kjo e zbuti disi mosmarrëveshjen mes djemve, por lakmia për vajzën nuk reshti me kaq dhe një rrezik i ri u shfaq. Një oficer i ushtrisë turke i cili shërbente në garnizonin e Beratit, mësoi për bukurinë e rrallë të Bukuroshes së Strumit u nis për ta gjetur. Mbërriti në fshat dhe u magjeps sikurse edhe të tjerët para tij. Bëri përpjekje për të fituar vëmendjen e saj, por vajza e refuzoi dhe u armatos. Ashtu e armatosur, ajo shkante në burim për të mbushur ujë a në arë për të ndihmuar të atin. Pikërisht kur oficeri humbi shpresat, ndodhi tragjedia. Oficeri një ditë u fut me dhunë në shtëpi të vajzës për ta rrëmbyer. Në përpjekje për t'u mbrojtur, vajza përdori armën dhe oficeri po ashtu. Në shkëmbimin e zjarrit mbetën të vrarë vajza e bukur dhe fatkeqe dhe i ati po ashtu fatkeq si ajo.

Vepra bashkëkohore skulpture dhe monumentale

Bukuroshja e Strumës

Bukuroshja e Strumës ka qenë burim frymëzimi për një këngë popullore me autor të panjohur, për një pikturë të viteve '80 me autor Pandeli Lenën e cila ruhet në Galerinë e Arteve në Fier dhe një legjendë që është ringritur në vëmendje të njerëzve për shkak të

përkushtimit të historianit Nuri Plaku i cili i ka kushtuar edhe një ese si pjesë të librit të tij “Bukuroshja e Strumes”.

Ky simbol domethënës i qytetit është plotësuar me një formë tjetër artistike, duke u derdhur në bronz. Vajza myzeqare, Bukuroshja jo vetëm e Strumes por e krejt Roskovecit, me shtëmbën mbi kokë, një kujtesë domethënëse e një kohe të shkuar, duket sikur pret të shuajë etjen e vizitorëve, por pse jo, të njohë e dashurojë edhe djalin e zemrës që sipas legjendës nuk pati kurrë fatin ta njohë.

Permasat e monumentit

- 1-Statuja është në bronz.
- 2-Dimensioni 350x80 cm (në ballor).
- 3-Bazamenti i statujës në gur Skrapari (i bardhë në okër) me permasa: 150 x 100 x100 cm.
- 4-Pesha totale e objektit në bronz afërsisht 5 ton.
- 5-Platforma në të cilën është vendosur ka diametër 30 m.
- 6-Në këtë platformë janë vendosur 14 shenjëza të simbolikës së ujit që identifikojnë 14 fshatrat që rrethojnë qytetin e Roskovecit.

Tregtari i Roskovecit

Tregtari me peshore është një statujë bronxi në hyrjen nga Berati të qytetit të Roskovecit. Sikurse shprehur bukur nga historiani Nuri Plaku, tregtari duket sikur kërkon të “peshojë” fatin e secilit vizitor që hyn e del nga ky qytet.

Disa të dhëna teknike:

- 1- Ideimi, modelimi i shtatores 180 cm.
- 2- Kolona me permasa: 120 cm gjatësia dhe 60 cm diametri.
- 3- Veshje e bazamentit me gurë të modeluar, me korniza.

Memoriali i Dëshmorëve

Sipas historianit Nuri Plaku, Roskoveci ishte vendi i parë në Myzeqe e Mallakastër i cili kontribuoi në Luftën Nacionalclirimtare me 451 forca partizane. Në memorial gjenden të gdhendur emrat e 72 dëshmorëve të atdheut.

USHQIMI I SHIJSHËM I ROSKOVECIT

Gatimet

Në restorantet e Roskovecit do të gjeni shijen e mrekullueshme të ushqimit tradicional shqiptar, me pjata si:

- Qumështuar (qumështor) dhe lakror saçi
- Tavë me Bibë me oriz ose makarona
- Çomlek furre me lepur dhe perime
- Byrek me miell misri
- Përshesh me gjel deti
- Mish qengji në hell
- Byrek me lakra, hithra

Biznes: “Bar Restorant “Algesti” Luar”

Adresa: Luar, Njësia Administrative Kuman, Bashkia Roskovec

Kontakt: Agim Cobo 0694582593, 0682743478

Produkti që tregton: Bar Restorant “Algesti” ofron gatime tradicionale të gatuar në saç si: qumështor, pershesh me gjel deti, tava me zogj fshati dhe bibë, pispili etj, të përgatitura me produkte

bio të zonës. I ndodhur në Luar, ngjitur me pyllin e Luarit me një panoramë dhe ajër që të mbush shpirtin.

Eksperienca në treg : 30 vjet

Biznes: “Sapuni Artizanal Roskovec”

Adresa: Punishtja e prodhimit të sapunit në qendër Vidhisht, Njësia Administrative Kuman, Roskovec

Kontakt: 0697765204

Produkti që tregton: 18 gra të vetëpunësuarra dhe të trajnuara nga një projekt përgatisin sapun dhe shampo artizanale hand-made me mbetje të vajit të ullirit dhe bimë aromatike të zonës. Këta sapun janë hidratues të shëndetshëm dhe kurativ për lëkurë të thatë dhe të dëmtuar.

Eksperienca në treg: Që nga viti 2018

Biznes: Sofra “Nertili”

Adresa: Bashkia Roskovec

Kontakt: 0686266613

Produkti që tregton Panorama e një biznes familjar Bar-Restorant i cili mirëpret që prej vitit 2011 mysafirë nga zona dhe jo vetëm.

Kur Klodian Selami u kthye nga emigrimi vendosi që ti dedikohet plotësisht biznesit të tij me qëllimin parësor për ta kthyer në agroturizëm me larmishmëri prodhimesh të fshatit nga ferma e tij.

Eksperienca në treg : Që nga viti 2011.

Biznes: “Bar Restorant “Elis Metush”

Adresa: Suk 1, Njësia Administrative Strum, Bashkia Roskovec

Kontakt: 0696158518

Produkti që tregton: Bar Restorant “Algesti” ofron gatime tradicionale të gatuarra në saç si: qumështor, përsesh me gjel deti, tava me zogj fshati dhe bibë, pispili etj.

Biznes: “Bar Restorant “Landi Hatia”

Adresa: Suk 1, Njësia Administrative Strum, Bashkia Roskovec

Kontakt: 0684047554

Eksperienca në treg: Që nga viti 1998

Vaji i ullirit

Ullishtat përcaktojnë jo vetëm peizazhin e Roskovecit por edhe shijen që prodhohet prej tij. Janë disa fabrika të cilat në Roskovec janë specializuar në prodhimin e vajit të ullirit i cili konsumohet jo vetëm në qytetin tonë por tregtohet edhe jashtë tij. Çdo vit në festën e ullirit ndahet një çmim i parë për vajin e vitit me cilësinë më të lartë.

Vizita juaj në Roskovec mund të mbyllet bukur me një vizitë në një prej fabrikave ku mund të blini dhe merrni me vete vaj cilësor me çmime të arsyeshme.

Lista e fabrikave të vajit të ullirit :

Biznes: “Fabrikë Vaji Italiane “Alim Hoxha” Kurjan”

Adresa: Kurjan, Bashkia Roskovec

Kontakt: Alim Hoxha 0696257851

Produkti që tregton: Fabrikë Vaji Italiane “Alim Hoxha me vendodhje në Kurjan prodhon dhe eksporton vaj ulliri extra të virgjër dhe 100% bio. Me një eksperiencë shumë vjeçare kjo fabrikë është një nga më të rëndësishmet në zonën tonë.

Biznes: Fabrikë vaji ulliri “Flamur & Teuta Pirra”

Adresa: Luar, Njësia Administrative Kuman, Bashkia Roskovec

Kontakt: Flamur & Teuta Pirra 0695334963

Produkti që tregton: Flamur dhe Teuta Pirra, partner në jetë dhe biznes, kanë ngritur një nga fabrikat më të rëndësishme të vajit të ullirit në fshatin Luar. Në këtë fabrike prodhohet dhe eksportohet vaj ulliri, me cilësinë extra Virgin nën logon “Luari extra virgin olive oil”.

Roskoveci Turistik

Eksperienca në treg: Që nga viti 2015

KANË THËNË PËR ROSKOVECIN

Nuk mund të mos ndajmë në këtë guidë orientuese një shkrim të autorit Edison Ypi për Roskovecin, një ode e mrekullueshme për qytetin tonë, dhe çfarë ky qytet përcjell si kontribut për Shqipërinë e bukur që vlen të çmohet dhe promovohet.

Çfarë shqiptarësh jeni ju o të mjerë që nuk e njihni...!

I vetmi vend në Shqipëri ku zemra punon si pompë, gjaku vërshon lumë, stomaku bluan si mulli, gjymtyrët lëvizin si vinça, veshët dëgjojnë deri në Vermosh, sytë shohin në fund të botës, goja buçet si daulle, bytha pjerdh si top, është Roskoveci.

Gishtat kodrinorë të Mallakastrës dhe luginëzat e Myzeqesë, zgjatur dhe mpleksur me njëra-tjetrën si duar të dashuruarish, diell, qiell, ajër, dritë, ujë, fusha, kodra, Roskoveci është aq magjepsës sa ta merr frymën, ta shpupuris mendimin, ta prish gjumin, ta sjell ëndrrën.

Roskoveci është vendi më i begatë i rruzullit. Edhe gurët hedhin rrënjë e nxjerrin fruta në Roskovec, të gjitha mizat bëjnë mjaltë, çfarë lëviz dashurohet e shumzohet, çfarë mbin rritet e korret, çfarë rrjedh pihet, çfarë kafshohet hahet, çfarë ëndërrohet realizohet.

Kalorës madhështor dhe krenar rrëzë kodrave anës fushës, Roskoveci ka tre gra, Myzeqenë, Mallakastrën, Lushnjën. Me tre gratë e tija Roskoveci ka bërë një tufë me kalamaj vajza e djem njëri më i bukur dhe më i shëndetshëm se tjetri; Patosin, Krutjen, Kutallinë, Marinzën, Zharrëzën, Ngurrëzën, Gorrenë, Strumën, Cukalatin, Bubullimën, si dhe plot hyzmeqarë dhe hyzmeqarka nëpër fushë e përmbi kodra që ç'u sheh syri u bën dora.

Në çdo vend të bukur njeriun e kap një merak dhe pyet veten; Mirë unë e dua këtë vend, por ky vend a më do vallë mua?

Në Roskovec kjo pyetje s'ka kuptim. Në Roskovec nga kjo dilemë nuk vuan. Mendo a e do ti Roskovecin, se dashuria e Roskovecit për ty është e garantuar, e pakursyer.

Roskoveci që ka gjithçka nuk trembet nga asnjë konkurrencë.

Nuk ka në Shqipëri vend si Roskoveci që fqinjët i do më tepër se veten. Aq e vërtetë është kjo, sa kur ndodhesh në Roskovec dhe sytë i ke hedhur nga veriu, ndjehesh myzeqar. Pa luajtur nga vendi, sheh nga jugu, në çast kthehesh në mallakastriot. Kthen kokën nga perëndimi, shndrohesh në fierak. E rrotullon nga lindja, bëhesh berates.

Kur i afrohesh Roskovecit konstaton se pakngapak gjithçka e egër që ke brenda vetes, po të zbutet. Ndjen sa e dëmshme është të gënjesh, të thurësh intriga, të merresh me thashetheme. Kur në Roskovec je, ndjen shplodhje, vuan më pak, dhimbjet pakësohen, hallet largohen, taksiratet harrohen.

Magjia e Beratit, energjia e Fierit, butësia e Lushnjës, konspiracioni i Myzeqesë, solemniteti i kishave dhe manastireve, perëndimet e përgjakura, laryshia e kodrave, pjelloria e tokës, kripa e detit, të gjitha mrekullitë e botës dhe ëmbëlsitë e jetës, takohen në Roskovec.

Kur pyet veten se ç'janë këto çudira që ndodhin në Roskovec, dhe nuk e gjen dot, të bëhet të besosh se diku aty rrotull Zoti ka mbledhur Krishtin, Muhametin, Budën, profetët, dhe të gjithë bashkë kokë më kokë po pine kafe e po llafosen për të mirën e njerëzisë.

Si të vishesh, si të krihesh, në cilën orë të nisesh, sa duhet të jetë temperature, lagështia, nga duhet të fryjë era, çfarë të kesh ngrënë e pirë para se të nisesh për Roskovec, janë probleme që secili i zgjidh vetë. Rëndësi ka kalorësin Roskovec të shkosh ta shohësh nga afër; sa të sigurtë e ka parzmoren, sa të madh e ka topuzin, a e ka të mprehtë

shpatën, a e ka të thatë barutin, sa e ngul plugun, sa të thellë e bën qilizmën, si e ka Rosinantin, a e gjeti Dylqinën.

Në Roskovec mund edhe të mos nisesh fare në stilin e Konfucit i cili ka thënë; “Nëse të shkrepet të shkosh diku, mos u nis, je atje”. Por e mira është të mos ngatërrohesh me kinezërira filozofike dhe në Roskovec të shkosh.

Kur të kthehesh nga Roskoveci, të përgjumurve të divaneve, zvarranikëve të bulevardeve, dembelave të kafeneve, sedentarëve të zyrave, thuaju; Çfarë shqiptarësh jeni o të mjerë që nuk njihni magjinë e Roskovecit? Turo që s’e keni pare. Faqja e zezë që s’e keni ndjerë. Ferri ju pret po nuk vajtët në Roskovec para se të vdisni.

REFERENCA

Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare*. Monografi. Botimet “Trifon Xhagjika” Tiranë, 2019.

Berat Luzha, *Roskoveci – Qyteti të cilin e krijoi Pazari i Roskovecit*. 16 Tetor 2022. <https://gazetalevizja.com/berat-luzha-shtegtime-neper-atdhe-ccxii-roskoveci-qyteti-te-cilin-e-krijoi-pazari-i-roskovecit/>

Edison Ypi, *Çfarë shqiptarësh jeni o të mjerë që nuk e njihni...!* 27 Gusht 2022. <https://www.cna.al/opinione/roskoveci-fare-shqiptarësh-jeni-o-te-mjere-qe-nuk-e-njihni-i325097>

Euronews Albania, *Roskoveci, vendi i ullinjve dhe ushqimit të përsosur*. 5 Nëntor 2020. <https://euronews.al/roskoveci-vendi-i-ullinjve-dhe-ushqimit-te-persosur/>

Gjovalin Shkurtaç, Tefë Topalli, Artjon Shkurtaç, *Sociolinguistikë e shqipes: Nga dialektologjia te etnografia e të folurit*. Shtëpia botuese Morava, 2009.

Ilirjan Gjika, *Pazari i Roskovecit bëhet me monument, zbulohet tregtari me veshje tradicionale*. 24 Korrik 2017. <https://politiko.al/pazari-i-roskovecit-behet-me-monument-zbulohet-tregtari-me-veshjen-tradicionale>

Ilirjan Gjika, *Roskoveci: Mbijetesa dymijëvjeçare e “qytetit stacion”*. 3 Nëntor 2016. <https://gazetamapo.al/roskoveci-mbijetesa-dy-mijevjecare-e-qytetit-stacion/comment-page-1/>

Ilirjan Gjika, *Pazari i Roskovecit*. 3 Tetor 2019. <https://www.facebook.com/450304618371334/posts/2466880883380354/>

Konica, *Bukuroshja e Strumit, vajza që çmendi edhe priftin*. 24 Dhjetor 2018. <https://konica.al/2018/12/bukuroshja-e-strumit-vajza-qe-cmendi-edhe-priftin/>

Kujtim Mateli, *Si u gjet “Bukuroshja e Strumës”*. 22 Shkurt 2022. <https://www.voal.ch/si-u-gjet-bukuroshja-e-strumes-nga-kujtim-mateli/kulture/jeta-artistike/>

News24, *Roskoveci në histori*. 26 Qershor 2022.
<https://www.news24.al/shqiperia-708/ulerima-tronditese-ne-kenete-banoret-rrefejne-ngjarjenne-thellesi--i53074>

Nuri Plaku, *“Bukuroshja e Strumit” na thërret të gërmojmë në zgafellat më të thella të kujtesës popullore, pse e meriton të bëhet pjesë e trashëgimisë kulturore*. 24 Mars 2019. <https://sot.com.al/aktualitet-dossier/bukuroshja-e-strumit-na-therret-te-germojme-ne-zgafellat-me-te-thella-te-kujteses>

Nuri Plaku, *Historiku i një qyteti të vjetër dhe të ri*. 15 Shtator 2021.
<https://arkiva.gazetadita.al/nga-pazari-i-roskovecit-te-nje-qytet-modern/>

Nuri Plaku, *Ali Ibrahim Çepele, themelues i qytetit të Roskovecit*. 13 Mars 2020.
<https://sot.com.al/opinion-editorial/ali-ibrahim-epele-themelues-i-qytetit-te-roskovecit-248>

Observerkult, *Historia e Kishës që u mbrojt nga myslimanët dhe legjenda e Bukuroshes së Strumit*. 27 Dhjetor 2021. <https://observerkult.com/historia-e-kishes-qe-u-mbrojt-nga-myslimanet-dhe-legjenda-e-bukuroshes-se-strumit/>

Pëllumb Xhufi, *Nga Paleologët tek Muzakajt*. Botimet 55, Tiranë, 2009.

Porta Vendore. *Pasaporta e bashkisë Roskovec*.
<https://portavendore.al/bashkia-roskovec/pasaporta-e-bashkise-roskovec/>

Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletorja Zyrtare Viti 2014, Nr. 137*.

Shqiptarja, *Strumi, kënetat që fsheh mistere*. 2 Nëntor 2017.
<https://shqiptarja.com/lajm/strumi-keneta-qe-fsheh-mistere-br-me-shpende-e-bime-unike-ne-bote-br>